



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr.Bi.No. 01 / 279
DATI DT. 03. 04. 2024
PRISHTINË - A

KGJK.nr.78/2024
Datë: 29 mars 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe të nenit 7 të Rregullores Nr.03/2019 Për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në Kuadër të Gjykatës Themelore Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, në takimin 323-të, të mbajtur me datë 29 mars 2024, merr këtë

V E N D I M

- I. Ndryshohet dhe plotësohet pika I, nën pika 3 e dispozitivit të vendimit KGJK.nr.439/2023, të datës 31 tetor 2023, sa i përket përbërjes së Komisionit për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Departamentit Special në Gjykatën e Apelit, ashtu që në vend të z. Vilard Bytyqi, anëtar caktohet z. Fidan Hoxha.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 29 mars 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.439/2023, të datës 31 tetor 2023, ka themeluar Komisionin për përzgjedhjen e gjyqtarëve të Departamentit Special në Gjykatën e Apelit.

Në proces u evidentua një gabim teknik sa i përket përbërjes së Komisionit, e cila kundërshtonte rregulloren saktësisht nenin 7 ku përcaktohet që “anëtarët e Komisionit duhet të jenë gjyqtarë me përvojë dhe të kenë të paktën pesë (5) vite përvojë si gjyqtarë, si dhe gjatë punës si gjyqtarë të mos kenë të shqiptuar ndonjë sanksion disiplinor”. Prandaj në këto rethana, Këshilli vendosi të ndryshoj vendimin KGJK.nr.439/2023, të datës 31 tetor 2023, ashtu që në vend të z. Vilard Bytyqi caktoi z. Fidan Hoxha, anëtar të këtij Komisioni, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Fidan Hoxha;
- Sekretariatit të KGJK-së, dhe
- Arkivit